

VENDIM
Nr. 143, datë 20.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë prej:

Gjyqtare: Shpëtime Pitaku

Asistuar nga sekretarja Lulzime Sofka, në Durrës, më datë 20.10.2022 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 1182/2759, datë 22.10.2021, regjistrimi, që i përket:

PADITËS: Ymer Lushakaj, i biri i Avdylit dhe i Zizes, i datëlindjes 3.4.1956, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë: lagjja “29 Nëntori”, Fier ose në hotel “Dolce Vita” te Shkëmbi i Kavajës, me arsim të lartë, i martuar, me 4 fëmijë, pensionist, adresa hotel “Dolce Vita” Golem, përfaqësuar nga av. Mirjan Moci, me nr. licence dhe nr. NIPT K31714511N, anëtar i Dhomës së Avokatisë Dega Durrës, në prani dhe në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit.

PALË E PADITUR: 1. Shoqëria “Fidens Project Finance”, ortak në shoqërinë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., me NIPT K72215501C, me seli në lagjen 4, Rruga Skënderbeg, pallati 405, shkalla 7/1, Durrës.

2. Shoqëria “Dyrrahu Konstruksion”, me adresë: lagjja nr. 4, Rruga Skënderbeg”, pallati 405, hyrja 7/1, Durrës.

PALË E TRETË: 1. Qendra Kombëtare e Biznesit, dega Durrës.

2. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me adresë në Durrës.

3. Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës.

OBJEKTI: 1. Prishjen e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., NIPT L72215501C.

2. Likuidimin e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., NIPT L72215501C.

3. Urdhërimin e QKB-së për çregjistrimin e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., me NIPT L72215501C.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, “Për falimentimin”, dhe neni 99, i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”; nenet 48, 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për QKB-në”, i ndryshuar; ligji “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar.

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, sipas përcaktimeve të nenit 36 e vijues të K. Pr. Civile dhe, se në bazë të neneve 41 e 42 e vijuese të K. Pr. Civile, ajo është kompetente për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse, këta kërkuar:

Pala paditëse – Pranimin e padisë.

Pala e tretë: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës – I kërkojmë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të marrë në konsideratë pretendimet e paraqitura më lart prej nesh, me qëllim përmbylljen sa më të shpejtë dhe në përputhje me parashikimet ligjore të procedurës së falimentit.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim, lidhur me çështjen civile,

VËREN:

Më datë 22.10.2021, pranë kësaj Gjykatë është regjistruar për gjykim çështja civile nr. 2759, që i përket palës paditëse Ymer Lushakaj, me objekt: Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion”.

Në gjykim rezultoi e provuar, se:

Paditësi Ymer Lushakaj është ortak me 33% të kuotave në shoqërinë tregtare “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., fakt që provohet me ekstraktin e QKB-së, si dhe me aktet e tjera të shoqërisë, të depozituara sipas ligjit në QKB. I padituri, shoqëria “Fidens Project Finance”, është ortaku tjetër me 66%, një shoqëri e huaj me seli në San Marino. Paditësi, Ymer Lushakaj, prej disa vitesh ka humbur kontaktet me ortakun tjetër edhe me vetë administratorin e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion”, të cilët kanë braktisur shoqërinë. Paditësi, edhe sipas ekstraktit historik të QKB-së, nuk është interesuar për mbarëvajtjen e shoqërisë, sepse pozita si ortak me 33% e ka vendosur në pozitën e pamundësisë së marrjes së veprimeve konkrete ligjore. Për këtë interes dhe për shkak të humbjes së kontakteve me palën e paditur, paditësi ka investuar një avokat të huaj, për të kërkuar të dhënat e njoftuara në Regjistrin Italian të Biznesit dhe nuk janë gjetur të dhëna në këtë regjistër, por avokati i huaj, ka gjetur të dhëna në San Marino për shoqërinë “Fidens Project Finance”, e cila është gjetur e falimentuar dhe e çregjistruar në vitin 2014, pasi kishte dhënë një hua prej 2.5 milionë eurosh.

Në këto rrethana, paditësi ka kërkuar të aplikojë në QKB, sipas statutit të shoqërisë dhe ligjit nr. 110/2016/2008, të ndryshuar, me qëllim zëvendësimin e administratorit, për të proceduar me shoqërinë. Ky fakt provohet me përgjigjen e QKB-së, sipas së cilës:

Asnjë veprim nuk mund të kryhet në regjistrin tregtar pa u përmbushur dy detyrimet, që janë konstatuar si kundërvajtje administrative:

1. Mosdorëzim i pasqyrave financiare për vitet 2013, 2014;
2. Mosdorëzim i statutit të ri të shoqërisë, sipas ndryshimeve ligjore.

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës, me këtë kërkesëpadi, duke u mbështetur në analizën ligjore, si vijon:

1. Braktisja, largimi, humbja e kontakteve midis ortakëve, provon faktin se kjo ortakëri nuk mund të ekzistojë më;
2. Dhe si e tillë apo për rrjedhojë logjike dhe ligjore as shoqëria “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k. nuk mund të ekzistojë.

Pretendimet e Drejtorisë së Tatimeve Durrës janë, si më poshtë vijon:

Në përputhje me parashikimet e nenit 86, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, konform parashikimeve ligjore të nenit 38, germa “d”, administrata tatimore konsiderohet si kreditor i preferuar në këtë procedurë falimenti.

Neni 38 **Kreditorët e preferuar**

Janë kreditorë të preferuar ata që paraqesin pretendimet e mëposhtme:

- a) pretendimet, që rrjedhin nga ndërprerja e kontratës së punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, duke përfshirë pagën dhe rimbursimet shëndetësore, pagesat e lejes së lindjes, të cilat nuk kalojnë shumën 500 mijë lekë në total për çdo kreditor;*
- b) pretendimet për shpenzimet e jetesës, që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori është një person fizik;*
- c) pretendimet e punonjësve të debitorit për dëme ndaj shëndetit, të shkaktuara gjatë punës;*
- ç) pretendimet për shpërblimin e dëmit ndaj jetës ose shëndetit, të shkaktuar nga veprimet e padrejta të debitorit përpara fillimit të procedurës së falimentimit;*
- d) pretendimet për detyrimet e lindura nga taksat dhe tatimet një vit përpara paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.*

Shoqëria “Dyrrahu Konstruksion”, NIPT K72215501C, person juridik, rezulton i regjistruar në organin tatimor, me objekt veprimtarie “Ndërtime civile dhe industriale, vepra arti, administrim baresh financim nëpërmjet dorëzarisë etj.”, rezulton debitor ndaj organit tatimor, ku referuar të

dhënave të administratës tatimore, pasqyruar në detyrimet në kohë reale, kapin vlerën 1.111.371 lekë, vetëm detyrimet e kontabilizuara, pa llogaritur këtu, deklaratat e padorëzuara të shoqërisë, të cilat, siç janë konstatuar nga vetë Gjykata, në procesin paraprak të përmbushjeve të kritereve ligjore për çeljen e procedurës, rezultojnë disa prej tyre ende të padorëzuara.

Për këtë arsye, i kërkojmë trupit gjykues të ngarkojë administratorin e falimentit, për marrjen e masave për deklarimin e këtyre deklaratave tatimore, të padorëzuara nga ana e tatimpaguesit. Gjithashtu, kërkojmë që nga ana e administratorit të falimentit të caktuar nga ana e Gjykatës, të behet verifikimi i asetëve totale të tatimpaguesit, si atyre materiale dhe atyre jomateriale, të kontaktohet me Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të verifikuar, nëse në emër të këtij tatimpaguesi rezultojnë kredi apo dorëzani të regjistruara, sikundër dhe të kontaktohet me ASHK-në për të verifikuar ekzistencën ose jo të pasurive të paluajtshme, si dhe të hartohet plani mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore që ky tatimpagues ka ndaj administratës tatimore.

II. Referuar nenit 64, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, konstatojmë se legjislatori ka përcaktuar ekzistencën e përgjegjësisë së pakufizuar të ortakëve, mbi detyrimet që shoqëria e zotëruar prej tyre ka ndaj kreditorëve të mundshëm. Bazuar në këtë parashikim ligjor, i kërkojmë trupit gjykues të ngarkohet administratori i falimentit me verifikimin e shkaqeve që kanë çuar në ekzistencën e paaftësisë paguese të kësaj shoqërie, si dhe akumulimit të detyrimeve që ajo ka, si dhe përfshirjen e tyre në planin e shlyerjes së detyrimeve, si pasojë e zhvillimit të procedurës së falimentit.

Neni 64

Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve

1. Nëse procedura e falimentimit fillon për pasurinë në pronësi të një shoqërie të thjeshtë ose një shoqërie me përgjegjësi të pakufizuar, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës mund të pretendojnë përgjegjësinë personale të ortakëve ndaj detyrimeve të kompanisë gjatë procesit të falimentimit.

2. Padia paraqitet në gjykatën e falimentimit dhe çdo pasuri ose mjet monetar i marrë nga gjykimi i saj do të jetë pjesë e masës së falimentimit.

Në të njëjtën frymë dhe neni 10, pika 2, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ka parashikuar, se themeluesit e një shoqërie tregtare, përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare, për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e detyrimeve ligjore apo detyrimeve ndaj palëve të treta, apo nga përmbushja e këtyre detyrimeve përtej afateve përkatëse.

Neni 10

Përgjegjësia e themeluesve

1. Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

2. Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve, të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit, sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

3. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrëjë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni. Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor, brenda 90 ditëve nga marrja dijani e mospërmbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të

ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. Ortakët, aksionarët ose kreditorët duhet të respektojnë procedurat e nenëve 91, 92, 150 e 151 të këtij ligji. Paditë duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare.

Në rastin objekt shqyrtimi na rezulton se shoqëria “Dyrrahu Konstruksion”, NIPT K72215501C, sipas detyrimeve në kohë reale të datës 7.11.2022, ka detyrime në shumën 1.111.371 lekë, vetëm detyrimet e kontabilizuara, sikundër dhe 26 deklarata të padorëzuara, të cilat jo vetëm që janë detyrim ligjor për t’u deklaruar, por në momentin e dorëzimit të tyre *online* do të prodhojnë penaltitetet përkatëse. Për të provuar interesin tonë të ligjshëm mbi këto detyrime dhe në përmbushje të parashikimeve ligjore, bashkëngjitur po i vëmë në dispozicion trupit gjykues detyrimet në kohë reale tek tatimpaguesit, datë 7.11.2022, si dhe detyrimet analitike, zë për zë, sipas llojit të tyre dhe datës së kontabilizimit të tyre në sistemin tatimor, me qëllim që të provojmë ligjshmërinë e kërimit tonë mbi shlyerjen e detyrimeve të kontabilizuara te tatimpaguesit.

Të gjithë këta tregues na japin informacionin e mjaftueshëm se kjo shoqëri, në mënyrë që të përmbyllë procesin e falimentit, ka detyrim të shlyejë më parë detyrimet ndaj administratës tatimore, pasi mospërmbushja e këtij detyrimi, jo vetëm që pengon çregjistrimin nga organet shtetërore, referuar këtu nenit 45, pikat 3.4 dhe 3.5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 45

Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve

3.4 Qendra Kombëtare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit në kohë reale rezultojnë detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes. Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjektet, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (e-mail) ose dhe me shkresë zyrtare.

3.5 Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit/subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklarata të padorëzuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar menjëherë në rruqë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

Në këto kushte i kërkojmë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Durrës të marrë në konsideratë pretendimet e paraqitura më lart prej nesh, me qëllim përmbylljen sa më të shpejtë dhe në përputhje me parashikimet ligjore të procedurës së falimentit.

Pasi analizoi në tërësi çështjen civile, pretendimet e ngritura në kërkesëpadinë për gjykim, aktet shkresore të paraqitura nga paditësi me cilësinë e provës dhe të administruara gjatë gjykimit dhe pasi u njoh me rezultatet e aktit të ekspertimit, gjykata vlerëson, se në këtë fazë duhet të hapen procedurat për falimentimin e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion”, për këto arsye:

Në analizimin e çështjes gjykata ka parasysh ligjin nr. 9901/2008, të ndryshuar, i cili përcakton në nenin 3/1, si vijon:

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Neni 99, i ligjit nr. 9901/2008 përcakton:

Neni 99

Sbkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;*
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;*
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;*
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;*
- d) me vendim të gjykatës;*
- dh) për arsye të tjera të parashikuara në statut.*

3. Neni 87/1 i këtij ligji përcakton:

Neni 87

Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 86, të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Çka do të thotë se kuorumi ka rëndësi të posaçme, sipas nenit 86 të këtij ligji, i cituar:

Neni 86

Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendose për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të këtij ligji.

Për sa më sipër, rruga e vetme për prishjen e ortakërisë dhe të shoqërisë mbetet rruga gjyqësore, sipas nenit 99, të ligjit nr. 9901/2008, të ndryshuar, i sipërcituar.

Në këto kushte, fakti rezulton i provuar, se:

1. Ortakëri me një shoqëri që nuk ekziston, nuk mund të ketë.
2. Me prishjen e ortakërisë del logjike, se nuk mund të vazhdojë as shoqëria “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k.

Pas depozitimit të kësaj kërkesëpadie, gjykata e falimentit, në referim të neneve 14 dhe 17, të ligjit nr. 110/2016, shqyrton përputhshmërinë e kërkesës me nenin 14 të këtij ligji, ku pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumentacionit vërtetohet gjendja e paafësisë paguese të debitorit.

Neni 14 i ligjit të sipërcituar parashikon, se:

“1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paafësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paafësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

- a) raportin e debitorit, ku përcaktohen sbkaqet e paafësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit,*
- b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;*
- c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vjetët e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kobe, për atë sa kjo periudhë është;*

c) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:
i. vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;
ii. vlerën aktuale të tregut, në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;
iii. vendndodhjen e pasurive; dhe/ose
iv. të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë, nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe
v. nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;
dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;
e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;

f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

2. Dokumentet, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsye të bazuara se përmbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, duhet të përcaktohet shprehimisht në tekstin e deklaratës.

3. Në rastin e një shoqërie të thjeshtë, ku anëtarët nuk janë individë, kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni do të zbatohen për anëtarët e organeve drejtuese të saj.”

Neni 17 i ligjit të sipërcituar parashikon, se:

“Shqyrtimi i kërkesës së debitorit

1. Nëse debitori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji. Në qoftë se, pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve, vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e procedurës brenda 5 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji. Nëse nuk vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese, gjykata e falimentimit refuzon kërkesën.

2. Nëse dokumentet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji nuk janë të plota, debitori i plotëson ato brenda 5 ditëve. Nëse brenda kësaj periudhe debitori nuk plotëson kërkesën, atëherë kërkesa i kthehet e pashqyrtuar.”

Për të verifikuar aftësinë paguese të shoqërisë “Dyrrahu Konstruktion”, gjykata mori provën me ekspert, në bazë të nenit 224/a të K. Pr. Civile, ekspertin kontabël Saimir Zalla, të cilit iu dhanë këto detyra nga gjykata:

1. Të verifikohet situata e kësaj shoqërie në marrëdhënie me shtetin, detyrimet që ka paguar dhe të papaguara, sa është vlera e detyrimeve të papaguara dhe kur kanë lindur ato

2. Të verifikohet situata e deklaratave të padorëzuara në tatime.

3. Të verifikohet nëse ka pasqyra financiare të dorëzuara për shoqërinë dhe kur është dorëzuar pasqyra financiare e fundit.

Sipas aktit të ekspertimit ka rezultuar, se: Organi tatimor ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7266/1, datë 10.10.2022, ku cilësohet që detyrimet e subjektit më datë 10.10.2022 janë 1.108.973 lekë.

Në bazë të shkresës që organi tatimor ka kthyer përgjigje rezulton që subjekti ka të padorëzuar në organin tatimor:

1. Gjashtë deklaratatë të kontributeve shoqërore që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

2. Gjashtë deklaratatë të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoret që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

3. Gjashtë deklaratatë të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

4. Dy deklaratatë të tatimit mbi fitimin që u përkasin viteve 2013 dhe 2014.

5. Gjashtë deklaratatë të tatimit mbi vlerën e shtuar që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

Në bazë të shkresës që organi tatimor ka kthyer përgjigje rezulton që subjekti ka dorëzuar bilance për periudhën 2007–2012, pra bilanci i fundit i dorëzuar është ai i vitit 2012.

Në këto pasqyra financiare, për vitet 2007–2012, te pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve nuk ka të shënuar asnjë shifër, gjë që nënkupton që kjo shoqëri për këtë periudhë nuk ka ushtruar veprimtari tregtare.

Aktivi i pasqyrave financiare rezulton vetëm me zërin parapagime, shpenzime të shtyra dhe të gjithë zërat e tjerë që mundësojnë likuiditetin e shoqërisë janë **zero lek**, për të gjithë periudhën 2007–2012.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126 dhe 306 e vijuese të K. Pr. Civile e në nenet 14, 17, të ligjit 110/2016, “Për falimentimin”, dhe në nenin 99 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Hapjen sot, më datë 20.10.2022, të procedurës së falimentimit ndaj shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., NIPT L72215501C, me administrator të shoqërisë, Aristide Benedetto.

Caktimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., znj. Arjeta Çumani, me adresë: lagjja “1 Maji”, rruga “Skënder Muska”, Fier, me nr. telefoni: 0692092483.

Në bazë të neneve 27, 141, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, kreditorët e tjerë, që do të vihen në dijeni të këtij vendimi, duhet t’i paraqesin administratorit të falimentimit, pretendimet e tyre, brenda datës 8.11.2022. Njoftohen të gjithë personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k. që t’ia paguajnë dhe t’ia shlyejnë këto detyrime administratorit të falimentimit. Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, mbledhja e kreditorëve të shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k. për raportim do të zhvillohet në datën 19.12.2022.

Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, ngarkohet administratori i falimentimit, që brenda datës 19.12.2022 të paraqesë në gjykatë një raport analize në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., për sa i përket mundësisë së vazhdimit të mëtejshëm të procedurës së falimentimit ndaj kësaj shoqërie.

Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, mbledhja e kreditorëve të shoqërisë për verifikim do të zhvillohet në datën 19.12.2022. Në bazë të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 197, datë 14.4.2007, administratori i falimentimit do të shpërblehet me masën fikse prej 50 mijë lekësh në muaj, e cila do të përballohet nga masa e falimentimit.

Në bazë të nenit 29, të ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”, vendimi i gjykatës, me anë të të cilit u vendos hapja e procedurave të falimentimit ndaj shoqërisë “Dyrrahu Konstruksion” sh.p.k., do të shpallet publikisht në këndin e njoftimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij në Gjykatën e Apelit Durrës.

U shpall në Durrës, sot, më datë 20.10.2022.

GJYQTARE
Shpëtime Pitaku